

20260340581

Në bazë të nenit 52 paragrafit (5) të Ligjit për Arsim Profesional dhe Trajnim („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 3/25 dhe 74/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës sollti

RREGULLORE PËR STRUKTURËN, ORGANIZIMIN DHE MËNYRËN E REALIZIMIT TË PROVIMIT TË MJESHTËRISË NË FUND TË ARSIMIT PAS TË MESËM

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet struktura, organizimi dhe mënyra e realizimit të provimit të mjeshtërisë në fund të arsimit pas të mesëm (në tekstin e mëtejme: provimi i mjeshtërisë).

Neni 2

Provimi i mjeshtërisë zhvillohet nga Oda e Zejtarisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, odat rajonale të zejtarisë, odat komunale të zejtarisë ose Oda e Zejtarisë së Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejme: oda e zejtarisë).

Provimi i mjeshtërisë realizohet nga këshilli i provimit dhe komisionet e provimit të formuara në përputhje me normativin për kuadrin mësimor të përcaktuar me programet mësimore për kualifikimin përkatës.

Neni 3

Provimi i mjeshtërisë zhvillohet në dy afate provimi gjatë një viti kalendarik.

Fillimi dhe përfundimi i afateve të provimit përcaktohen nga këshilli i provimit për provimin e mjeshtërisë, i cili formohet nga oda e zejtarisë.

Neni 4

Provimi i mjeshtërisë mund të jepet vetëm në një afat provimi, vetëm një herë.

Neni 5

Provimi i mjeshtërisë përbëhet nga katër pjesë:

- pjesa praktike,
- pjesa profesionale-teorike,
- pjesa menaxheriale/juridiko-ekonomike dhe
- pjesa pedagogjiko-andragogjike.

Pjesa praktike, pjesa profesionale-teorike, pjesa menaxheriale/juridiko-ekonomike dhe pjesa pedagogjiko-andragogjike e provimit jepen në përputhje me programet e provimit për provimin e mjeshtërisë.

Pjesa praktike e provimit mund të zgjasë së paku tetë orë, ndërsa më së shumti 40 orë, në varësi të programit të provimit për pjesën praktike për kualifikimin përkatës për mjeshtër.

Pjesa profesionale-teorike, pjesa menaxheriale/juridiko-ekonomike dhe pjesa pedagogjiko-andragogjike e provimit të mjeshtërisë, zgjasin nga 120 minuta.

Neni 6

Pjesët e provimit të mjeshtërisë nga neni 5 paragrafi 1 i kësaj rregulloreje mund të jepen në afate të ndryshme provimi dhe nuk kanë karakter eliminues.

Në një afat provimi, kandidati mund vetëm një herë t'i nënshtrohet pjesëve të provimit të mjeshtërisë.

Neni 7

Nga ana e këshillit të provimit, afatet për dhënien e provimit të mjeshtërisë shpallen në tabelën e njoftimeve dhe në faqen e internetit të odës së zejtarëve; formohen komisione të provimit sipas sektorëve përkatës dhe përpilohet lista e kandidatëve sipas profesioneve përkatëse.

Nga këshillit i provimit, më së voni pesë ditë pas skadimit të afatit të paraparë për paraqitje, kandidati informohet për plotësimin e kushteve për dhënien e provimit të mjeshtërisë, si dhe për fillimin dhe përfundimin e provimit të mjeshtërisë.

Në rast se konstaton se kandidati ka dokumentacion jo të plotë, kandidati informohet për mangësitë në dokumentacion më së voni tre ditë nga dita e konstatimit. Kompletimi i dokumentacionit bëhet më së voni tetë ditë nga dita e pranimit të njoftimit.

Në rast se kandidati nuk i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për dhënien e provimit të mjeshtërisë, këshilli i provimit e njofton me shkrim kandidatin, personalisht ose me postë, më së voni tetë ditë nga dita e konstatimit.

Neni 8

Provimi i mjeshtërisë është publik dhe jepet para komisionit të provimit. Për të katër pjesët e provimit të mjeshtërisë, për secilën kualifikim për mjeshtër veçmas, nga ana e këshillit të provimit formohen komisione provimi, si vijon:

- për pjesën praktike,
- për pjesën profesionale-teorike,
- për pjesën menaxheriale / juridiko-ekonomike dhe
- për pjesën pedagogjiko-andragogjike.

Neni 9

Provimi praktik zhvillohet në punëtori artizanale (punëtori), në bazë të marrëveshjes së lidhur me Odën e Zejtarëve, e cila e organizon dhe e realizon provimin.

Neni 10

Këshilli i provimit, më së voni tetë ditë pas përfundimit të afatit për paraqitje, e publikon orarin e kandidatëve të cilët i nënshtrohen provimit të mjeshtërisë.

Orari i mbajtjes së provimit të mjeshtërisë përcaktohet nga këshilli i provimit të Odës së Zejtarëve.

Neni 11

Kandidati i cili ka filluar t'i nënshtrohet provimit të mjeshtërisë, ndërsa gjatë provimit për shkak të sëmundjes ose arsyeve të tjera të justifikuara, është penguar ta vazhdojë dhënien e provimit, për këtë duhet ta njoftojë këshillin e provimit të Odës së Zejtarëve dhe të dorëzojë dëshmi përkatëse për arsyen.

Këshilli i provimit vlerëson nëse pretendimet e kandidatit janë të bazuara dhe e cakton termin për dhënien e provimit.

Neni 12

Pjesët profesionale-teorike, menaxheriale/ligjore-ekonomike dhe pedagogjike-andragogjike zhvillohen me shkrim.

Nga komisionet e provimit për zbatimin e pjesëve profesionale-teorike, menaxheriale/ligjore-ekonomike dhe pedagogjike-andragogjike të provimit propozojnë teste bazuar në programet e provimit për provimin e mjeshtërisë.

Neni 13

Pjesa praktike e provimit të mjeshtrit në veprimtarinë përkatës të zejtarisë kryhet përmes:

- përgatitja për kryerjen e detyrës;
- realizimi i detyrës praktike;
- justifikimi me gojë i detyrës; dhe
- provimi me gojë i teorisë profesionale.

Neni 14

Detyrat e punës për pjesën praktike përcaktohen nga komisioni i provimit bazuar në programin e provimit.

Përgatitja për kryerjen e detyrës praktike përfshin skica, llogaritje, specifikime të materialeve, veglave, pajisjeve, instrumenteve etj.

Përgatitjen për kryerjen e detyrës praktike e bën çdo kandidat vetë në punëtori artizanale. Si përjashtim, për shkak të natyrës së detyrës praktike, mund të vendoset që nuk ka nevojë për përgatitje të detyrës praktike..

Me justifikim me gojë të detyrës praktike të kryer verifikohet aftësia e kandidatit për të shpjeguar zgjedhjet, përmbajtjet, procedurat, metodat etj., që ka përdorur gjatë realizimit të detyrës. Justifikimi me gojë zgjat më së shumti 20 minuta.

Neni 15

Çdo pjesë e provimit të mjeshtërisë vlerësohet veçmas, sipas pragut të kalueshmërisë për secilën pjesë të provimit.

Pragu i kalueshmërisë për të gjitha pjesët e provimit të mjeshtërisë është përfshirë në programet e provimit të mjeshtërisë.

Suksesi i pjesëve individuale të provimit të mjeshtërisë, si dhe i provimit në tërësi, vlerësohet me notën “kaloi” ose “nuk kaloi”.

Gjatë vlerësimit të çdo pjesë të provimit të mjeshtërisë, çdo anëtar i komisionit të provimit vlerëson veçmas kandidatin, më pas rezultatet e të gjithë anëtarëve mbledhen dhe llogaritet vlera mesatare.

Vlerësimi i realizimit të detyrave praktike kryhet nga komisioni i provimit. Për kryerjen e pjesës praktike, çdo anëtar i komisionit vlerëson individualisht, sipas detyrës së caktuar.

Për ta kaluar me sukses provimin, kandidati duhet të marrë numrin minimal të pikëve në secilën fushë të vlerësimit.

Pragu i kalueshmërisë i përfshin njohuritë dhe aftësitë më të domosdoshme që kandidati duhet të demonstrojë në secilën pjesë të provimit.

Provimi i mjeshtërisë konsiderohet i kaluar nëse kandidati i ka kaluar të katër pjesët.

Kandidati i cili ka marrë notën „nuk kaloi” në ndonjë pjesë të provimit të mjeshtërisë, udhëzohet që ti nënshtrohet përsëri pjesës së provimit në afatet e ardhshme të provimit.

Kandidati që nuk e ka realizuar me sukses detyrën praktike, nuk paraqitet për mbrojtjen e saj dhe udhëzohet që t'i nënshtrohet përsëri pjesës praktike.

Neni 16

Nga ana e këshillit të provimit, për çdo pjesë të dhënë të provimit të mjeshtërisë, më së voni tetë ditë nga dita e dhënies së provimit, shpallet lista e kandidatëve të suksesshëm në tabelën e shpalljeve të odës së zejtarëve, ndërsa të gjithë kandidatët duhet të njoftohen për rezultatet e provimit të mjeshtërisë me postë ose në mënyrë elektronike, më së voni tre ditë nga dita e publikimit të listës së kandidatëve të cilët e kanë dhënë provimin.

Kandidati, më së voni tre ditë nga dita e marrjes së njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të parashtojë kërkesë me shkrim për shqyrtimin e dokumentacionit të tij të provimit.

Nga ana e kryetarit të këshillit të provimit i mundësohet kandidatit shqyrtimi i dokumentacionit të tij të provimit, më së voni dy ditë nga dita e marrjes së kërkesës nga paragrafi 2 i këtij neni.

Kandidati mund të parashtrijë kundërshtesë pranë këshillit të provimit kundër vendimeve të komisionit të provimit, më së voni tre ditë nga dita e kryerjes së shqyrtimit të dokumentacionit të tij të provimit.

Neni 17

Procesverbalet e komisioneve të provimit për secilin kandidat mbahen nga procesmbajtësit e komisioneve të provimit dhe ruhen në arkivin e odës së zejtarëve, si vlerë e përhershme.

Libri kryesor nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari i këshillit të provimit të odës së zejtarëve.

Neni 18

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për strukturën, organizimin dhe zbatimin e provimit të mjeshtërisë("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 36/08 dhe 200/18).

Neni 19

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga data e publikimit të saj në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 18-2863/1
16.02.2026
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Prof. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.